



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:022839

Datë: 31.03.2022

Numri i dokumentit: 02867285

**PKR.nr.48/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda**, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit K. M.nga fsh. .... K. I, për shkak të kryerjes së veprës penale “*Vrasje e mbetur në tentative*”, nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I Nr. 32/2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.03.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit, Lumturije Vuçetaj, të akuzuarit K. M. dhe mbrojtësit të tij, av. Z. B. sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 31.03.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I akuzuari:***

**K. M.** i lindur me dt. 01.09.1981 në Fsh..... K. I ku edhe banon, nga i ati A. dhe e ëma H. e gjinisë M. i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me numër personal ..... posedon nr. të telefonit ..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet nën masën e paraburgimit sipas aktvendimit të GJTH në P, gjyqtarit të procedurës paraprake nën shenjen DKR. PP nr. 33/22 nga dt. 03.03.2022 e në vijim.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

Me datë 03.02.2022, rreth orës 17:30, në fshatin .... K. I, me dashje dhe me mjet të mprehtë të llojit thikë, tenton ta privojë nga jeta këtu të dëmtuarin A. Z. në atë mënyrë që, pas një konflikti verbal që kishte ndodh një ditë me herët në mes tyre, natën kritike me tu takuar në lokalit e dëshmitarit V. P. i cili gjendet në vendin si me lartë, fillimisht në mes tyre është zhvilluar një bisedë për rastin që kishte ndodhë me parë dhe te njëjtit i shtrijnë dorën e pajtimit njeri-tjetrit, me ç’ rast me të dal i dëmtuari jashtë lokalit menjëherë pas tij del i pandehuri dhe papritmas me mjetin thikë me gjatësi prej 17 cm, godet të dëmtuarin në pjesën e abdomenit në anën e majtë si dhe me grusht në pjesën e epërme të buzës së anës së djathtë, duke i shkaktuar plagës shpuese në regjionin e barkut e te cilat kane qene te rrezikshme për jetën e te dëmtuarit, ndërsa pas ekspertimit mjeko-ligjor te njëjtat janë konstatuar si lëndime të lehta trupore me pasoja te përkohshme në shëndetin e tij,

- me çka ka kryer veprën penale “**Vrasje**” e mbetur në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata në aplikim të dispozitave ligjore nga neni 4, 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40 par. 1 pika 1.2, 42, 69, 70, 71, 72 par. 1 pika 1.2, neni 172 dhe neni 28, të KPRK-së, neni 365, 366, 367 par. 1 pika 1.1 dhe par. 3, të KPPRK-së, të akuzuarin K. M. e

## **G J Y K O N**

- I. Me dënim burgimi efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite.
- II. Në dënimin e shqiptuar konform neni 79 par. 1, të KPRK-së, i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt. 03.02.2022, e tutje.
- III. Të pandehurit K. M. në kuptim të neni 367 par. 1 pika 1.1 dhe par. 3, të KPPRK-së, i vazhdohet paraburgimi sipas aktvendimit të fundit nën shenjen DKR PP Nr. 33/22 dhe atë nga dita e shpalljes së aktgjykimit e deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar.
- IV. Obligohet i pandehuri në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe paushallit gjyqësor në shumën e përgjithshme prej 150 (njëqind e pesëdhjete) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjete) euro.
- V. Ndaj të pandehurit, K. M. i shqiptohet:

### **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI**

- VI. **KONFISKOHET** një (1) thike dhe e njëjta ka për tu shkatërruar pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, e cila
- VII. Pala e dëmtuar A. Z. udhëzohet në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 32/2022 të datës 15.03.2022, kundër të akuzuarit, K. M. nga fsh. .... Komuna e I, për shkak të veprës penale, “*Vrasje e mbetur në tentativë*”, nga neni 172 e lidhur me nenin 28, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 24.03.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit, i pandehuri K. M. dhe mbrojtësi i tij, Av. Z. B. sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit nën shenjen PP/I Nr. 32/2022, të datës 15.03.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësin që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e

fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konfrom nenit 248 par. 1, pika 1.1-1.4 të KPPRK-së.

I akuzuari pas njoftimit me të drejtat e tij, është deklaruar fajtor për veprën penale “**Vrasje e mbetur në tentative**”, nga neni 172 e lidhur me nenin 28, të KPRK-së, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, dhe mbrojtësi i të pandehurit se pajtohen me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata me aktvendim procedural, ka aprovuar pranimin e fajësisë me Aktvendim procedural, me bindjen se i akuzuari pranimin e fajësisë është bërë konform dispozitës së nenit 248 par 1 pika 1.1-1.4 të KPPRK-së, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes dhe shkresave të lëndës dhe provat vijuese: *Raportit të oficerit R. A. # të datës 04.02.2022, raporti i oficerit V. B. # i datës 03.02.2022, raporti i oficerit Z. S. # i datës 03.02.2022, deklarata e të dëmtuarit A. Z. e dhënë në Spitalin e P e datës 03.01.2022 si dhe në prokurori me dt.07.03.2022, deklarata e të pandehurit K. M. e dhënë në stacionin policor në I në prezencën e avokatit mbrojtës e datës 04.02.2022 si dhe në prokurori me dt.07.03.2022, deklarata e dëshmitarit V. P. e dhënë në P me datë 03.02.2022 si dhe në prokurori me dt.18.02.2022, deklarata e dëshmitarit M. P. e dhënë në stacionin policor në I me datë 03.02.2022 si dhe në prokurori me dt.18.02.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 03.02.2022, përmbajtja e dosjes së Forenzikës e përpiluar nga Njësia e Forenzikës me nr. bashkë me foto-albumin, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, informacionet mbi të kaluarën kriminale për të pandehurin K. M. e nxjerrë nga baza-policore, aktgjykimi dënues nën shenjën P.nr.192/11 dhe aktgjykimi tjetër nën shenjën P.nr.151/18, nga të cilat vërtetohet se i njëjti është i njohur për organet e drejtësisë për vepra të ndryshme dhe Akt ekspertimi mjeko-ligjor nga dr.F. B. i dt.14.02.2022 dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit, se e pranon fajësinë, në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i pandehuri është penalisht përgjegjës dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënonte sipas ligjit si dhe ta obligon në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rasti e marrjes së vendimit mbi dënimin i ka propozuar gjykatës që ta merr parasysht rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, pendimi për veprën e kryer, marrëveshja e pajtimit në mes dy familjeve e dt. 23.02.2022, ndërsa si rrethana renduese ka potencuar shkallen e lartë të përgjegjësisë penale se të pandehurit si dhe dënuesmerine e tij të mëparshme, pasi që i njëjti është shpallur fajtor edhe me herët dhe atë me aktgjykimet nën shenjën P.nr. 192/11 dhe P.nr. 151/18.*

Mbrojtësi i të pandehurit K. M. av. Z. B. në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *megenëse i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë, me familjen e të dëmtuarit janë pajtuar menjëherë pasi që i dëmtuari ka dalur nga spitali, është konstatuar se i dëmtuari ka pësuar lëndimet e lehta trupore të cilat nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën e tij, vet i dëmtuari, vëllai i tij dhe tezaki i tij janë marr vesh dhe të pandehurit ja kanë fal, dhe po ashtu kanë rivendos marrëdhëniet si me parë para ndodhjes së rastit, i propozon gjykatës që të gjitha këto të cekura të merr si rrethana lehtësuese dhe ndaj të pandehurit të shqipton një dënim sa me të bute.*

I pandehuri K. M. ka deklaruar se: *e përkrah fjalën përfundimtare e mbrojtësit tij, me familjen e të dëmtuarit janë pajtuar, është i penduar shumë për veprën e kryer dhe i kërkon falje të dëmtuarit për rastin që ka ndodhur, po ashtu ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, dhe ne fund i ka propozuar gjykatës që tia shqipton një dënim sa më të lehte.*

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, **“Vrasje e mbetur në tentative”**, nga neni 172 e lidhur me nenin 28, të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se te i pandehuri, ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

KTGJ me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të akuzuarin mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, lidhur me par.3 pika 3.6 dhe nenit 70 par. 1e lidhur me par. 3 pika 3.8, 3.9, 3.10, 3.11 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, *pendimi për veprën e kryer, marrëveshja e pajtimit ne mes dy familjeve e dt. 23.02.2022, natyrën e lëndimeve pas ekspertimit mjeko ligjorë të cilat kanë rezultu te jenë lëndime te lehta trupore, ndërsa si rrethana renduese konform nenit 70 par. 2 pika 2.13 gjykata mori se i njëjti kishte qenë më parë i shpallur fajtor edhe me herët dhe atë me aktgjykimet nen shenjen P.nr. 192/11 dhe P.nr. 151/18, e qe dy aktgjykimet kishin të bëjnë me armbajtje pa leje, ku ne te parin P.nr. 192/11 te dt. 19.09.2011 i është shqiptuar dënim me gjobë ne shumë prej 225 euro, ndërsa për aktgjykimin P.nr. 151/18 te dt.25.04.2018, po ashtu kemi te bëjmë me dënim për armëmbajtje pa leje nga neni 374 par.1 të KPRK-ës, për të cilin është shpallur fajtor. Rrethana te cilat i konfirmoi prokurorja gjatë shqyrtimit gjyqësor, e pjesërisht edhe mbrojtësi i tij, ky i fundit ne fokusim të rrethanave shtesë se lëndimet ishin te natyrës se lehtë bazu ne ekspertimin dhe se në mës tyre tani janë rivendosur menjëherë si më parë mesë familjeve.*

KTGJ, në aplikim te dispozitave mbi zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1,pika 1.1, 1.2, 1.3, dhe nenit 72 par. 1 pika 1.2 qe i referohet kufijve të zbutjes se dënimit ku thuhet: citoi 1.2 te nenit 72 të KPRK-ës, Se nëse për vepër është paraparë si masë më e ulët dënimit me burgim prej (5) pesë vjetë burgim, dënimi mund te zbutet deri në 3 (tri) vite. Ne rastin konkret ndaj të pandehuri për veprën penale është gjykuar me dënim burgimi prej 3 (tri) vite, burgimi në përputhje me rregullat e zbutjes –kufijtë e zbutjes se dënimit.

KTGJ, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e e tij , me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KP-së.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me burgim u morr konform nenit 42 par. 1 dhe nenit 172 të KPRK-së.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së të akuzuarit në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga dt. 03.02.2022 e tutje.

Konform nenit 367 par. 1 pika 1.1 dhe par. 3 të KPPRK-së, të akuzuarit i është vazhduar paraburgimi sipas aktvendimit e fundit nën shenjen DKR PP Nr. 33/22 dhe atë nga dita e shpalljes së aktgjykimit e deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për konfiskimin e armës se përdorur në kryerjen e veprës penale, u morr konform nenit 366 par. 3, të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**DKR.nr.48/22 dt. 31.03.2022**

**Zyrtari ligjor**  
Alan Taranish

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Dr.sc.Murat Hulaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.